



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-94
Prishtinë, më 1 mars 2010, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 1 MARS 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lulzim Zeneli, Petar Miletiq, Xhezair Murati dhe Numan Baliq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Selman Ymeri dhe Shefqet Rexhepi.

Nga OSBE: Floriana Shala.
Nga ZCN: Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryetari tha se ndërkohë kryeministri i Republikës së Kosovës, Kuvendit ia ka dërguar një dokument të emërtuar “ Përmbledhje e Strategjisë për Veriun e Kosovës”.

Ky material u është shpërndarë anëtarëve të Kryesisë dhe kryetarëve të grupeve parlamentare. Ai propozoi që Kryesia ta procedojë këtë material.

Kryesia mbështeti propozimin e kryetarit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 19 dhe 23 shkurt 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 19 dhe 23 shkurt 2010

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 19 dhe 23 shkurt 2010, u miratuan pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare, më 11 mars 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e ardhshme plenare të mbahet më **11 mars 2010**, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 25. 02. 2010,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-28 për procedurën administrative,
4. Shqyrtimi i parë Projektligjit për Avokatin e Popullit,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit,

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar,
7. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë së energjisë për periudhën 2009-2018,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Kërkesa e Grupit Parlamentar për Integrim për emërimin e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, nga komuniteti serb, me rotacion

Kryesia konstatoi se anëtari i Kryesisë së Kuvendit, nga komuniteti serb, është emëruar në bazë të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit. Kërkesa për ndërrimin eventual të tij duhet të jetë në pajtim me marrëveshjen e brendshme të deputetëve të Kuvendit, të cilët përfaqësojnë komunitetin serb.

3.2 Propozim–vendimi për kompensimin e ekspertëve të jashtëm në komisionet parlamentare

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M **për kompensimin e ekspertëve të jashtëm në komisione parlamentare**

1. Eksperti i jashtëm, i angazhuar nga komisioni parlamentar, kompensohet në shumën 50 €, për një mbledhje.
2. Mjetet buxhetore për kompensimin e ekspertit, paguhen nga buxheti i komisionit.
3. Komisioni mund të angazhojë ekspertin e jashtëm nga lista e ekspertëve, të miratuar nga komisioni.

3.3 Propozimi për punësimin e stafit për mbështetje të komisioneve parlamentare

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimi e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

I. Miratohet propozimi i sekretarit të Kuvendit për punësimin e stafit për mbështetje Të komisioneve parlamentare, si vijon:

- Zyrtar i fushës për ekonomi dhe financa në Komisionin për Buxhet e Financa,
- Zyrtar i fushës për ekonomi dhe financa në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike,

- Zyrtar i fushës për Integritet Evropian në Komisionin për Integritet Evropian,
- Zyrtar i fushës për politikë të jashtme në Komisionin për Punë të Jashtme,
- Zyrtar i fushës teknike në Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion,
- Zyrtar i fushës për mjedis në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,
- Zyrtar i fushës për arsim në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport,
- Zyrtar i fushës për shëndetësi në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale,
- Zyrtar i fushës për siguri në Komisionin për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës,
- Zyrtar i lartë ligjor,
- Zyrtar i lartë për legjislacion (2),
- Zyrtar për partneritet evropian.

II. Ngarkohet sekretari i Kuvendit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale për shpalljen e konkursit, caktimin e Komisionit për selektimin dhe intervistimin e kandidatëve për pozitën e shpallura me këtë konkurs.

3.4 Kërkesa e kryetarit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i kryetarit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, z. Esat Brajshori, për të marrë pjesë në vizitë studimore, me titullin: “Procesi i dialogut të asocimit dhe stabilizimit”, të organizuar nga Komisioni Evropian, në Bruksel, prej 03 - 06 mars 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurin sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit.

3.5 Përmbledhja e Strategjisë për Veriun e Kosovës

Kryesia vendosi që Strategjia për Veriun e Kosovës, e hartuar nga Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Zyrën Civile Ndërkombëtare, t'u dërgohet deputetëve të Kuvendit për seancë plenare, më 4 mars 2020.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale